

INTERNET www.bundesgesundheitsministerium.de
www.zusammengeqencorona.de

Rregulla në lidhje me koronavirusin SARS-CoV-2/COVID-19 për personat që hyjnë në Gjermani

Shumë të nderuar udhëtarë,

Ju urojmë përzemërsisht: Mirëserdhët në Gjermani! Ju lutem respektoni këto udhëzime të rëndësishme:

- Kur hyni nga bota e jashtme në Republikën Federale të Gjermanisë dhe kur keni qëndruar 10 ditë para hyrjes në një **zonë rreziku**, sipas legjislacionit të landeve federale, si rregull, jeni të detyruar që **menjëherë** pas hyrjes të shkoni në rrugë direkte **në shtëpinë tuaj ose në një strehim tjetër të përshtatshëm** si dhe të qëndroni në vazhdimësi pa ndërprerje atje për një periudhë kohore prej 10 ditësh që pas hyrjes suaj në Gjermani (karantinë). Shkeljet mund të ndiqen si **kundërvajtje** me një gjobë deri në 25 000 EURO.
- **Zonë rreziku** është një shtet ose rajon jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, për të cilin apo për të cilën, në kohën e hyrjes në Republikën Federale të Gjermanisë, ekziston një rrezik i shtuar i infektimit me koronavirusin SARS-CoV-2. Instituti Robert Koch e përditëson vazhdimisht listën e zonave të rrezikut në lidhjen: <https://www.rki.de/covid-19-risikogebiete>
- **Para se të hyni** në Gjermani, duhet të **regjistroheni** në <https://www.einreiseanmeldung.de> dhe ta **keni me vete dëshminë kur të hyni** në Gjermani. Dëshmia do të kontrollohet nga transportuesi juaj dhe, në rast nevojë, edhe nga Policia Federale në kuadër të kontrollit të hyrjes në Gjermani; përveç kësaj, Policia Federale kryen edhe kontrole në kuadër të detyrave të saj si polici kufitare (p.sh. kur hyni në rrugë tokësore).
- Në rastet kur nuk e keni të mundur që të bëni një regjistrim digjital të hyrjes, për shkak të mungesës së pajisjeve teknike ose të një difekti teknik, jeni të detyruar të plotësoni një deklaratë zëvendësuese. Ju lutem shikoni në udhëzimet e deklaratës zëvendësuese, se ku duhet ta dorëzoni atë (p.sh. te transportuesi ose te Deutsche Post E-POST Solutions GmbH, 69990 Mannheim).
- Përveç kësaj, ju duhet të keni **dëshmi të testit jo më vonë se 48 orë pas hyrjes suaj** në Gjermani dhe t'ia paraqisni atë autoritetit kompetent, nëse e kërkon atë brenda 10 ditëve nga hyrja. Dëshmi konsiderohen një çertifikatë mjekësore ose një rezultat i testit në lidhje me mosinfektimin me koronavirusin SARS-CoV-2.
- Nëse po hyni në Gjermani nga një **zonë me rrezik veçanërisht të lartë** për t'u infektuar me SARS-CoV-2, duhet të **testoheni para nisjes**, sepse duhet të paraqisni një dëshmi kur të hyni, kur t'ju kërkohet nga autoriteti kompetent ose nga Policia Federale. Në rastet kur përdorni një transportues, dëshminë duhet t'ia paraqisni transportuesit tuaj që para nisjes. Zona me rrezik veçanërisht të lartë janë zonat ku ekziston një rrezik i veçantë i infektimit për shkak të përhapjes së mutacioneve të virusit ose për shkak të incidencave veçanërisht të larta. Edhe këto publikohen në faqen e sipërpërmendur të Institutit Robert Koch.
- Në lidhje me detyrimin për karantinë, respektoni legjislacionin e landit federal të zbatueshëm për ju dhe mbani mend se karantina 10-ditore si rregull i përgjithshëm mund të përfundojë më e herta pas ditës së pestë pas hyrjes në Gjermani me një rezultat negativ të testit.
- Edhe kur rezultati i testit është negativ, ju keni detyrimin të **kontaktoni menjëherë Zyrën e Shëndetit Publik** (<https://tools.rki.de/plztool/>) kompetente për ju, kur 10 ditë pasi keni hyrë në Gjermani keni **simptoma tipike** (vështirësi në frymëmarrje, kollë të re, ethe ose humbje të nuhatjes ose shijes) të infektimit me koronavirusin SARS-CoV-2.

Ministria juaj Federale për Shëndetin



Zona rreziku



Rregulla higjenike